



NEWSLETTER NO. 3

YOUTH FOR CHANGE

Ngritja e Këshillit Rinor si Pjesë e Qeverisjes Vendore në Rrethin e Kurbinit

✓ Marshime Ndërgjegjësuese

✓ Editorial - Kurbini: Mundësi vs Sfida

✓ Editorial - Rëndësia e zbatimit të projekteve sistematike të shoqërisë civile për të siguruar informacionin dhe mbështetjen e të rinjve drejt integritit në Bashkimit Evropian Enejda Groshi

✓ Refleksione rinore

Financuar nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit "YOUth FOR CHANGE"

i cili realizohet me mbështetjen financiare të LevizAlbania dhe është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

Adresa: Rruga e Kosovarëve,
Nd. 37, H.1 Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri
(pranë digës së Liqenit Artificial)

E-mail: info@youthact.al
Web: www.youthact.al
Tel: +355 69 33 16 551



 YouthAct Albania

Aktivizëm Rinor

Duke pasur parasysh përpjekjet që bëhen për të angazhuar vazhdimisht struktura të komunitetit në procese vendimmarrëse e në llogaridhënie të punës së qeverisjes vendore, mund të pohohet me siguri që angazhimi i të rinjve përmes Këshillave Rinorë në këto procese është një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të një shoqërie demokratike. Shumë të rinj e projektojnë veten si udhëheqës të së ardhmes. Prandaj shihet i nevojshëm ndërgjegjësimi i tyre që në rininë e hershme mbi rëndësinë e përfshirjes në vendimmarrje. Qeverisja vendore, angazhimi komunitar, forcimi i aktivizimit qytetar, vendimmarrja etj. diskutohen

më vete. Arritja e rezultateve pozitive në bashkëpunim me stafin e qeverisjes lokale, gjithashtu.

Si mund t'ua shpjegojmë të rinjve vështirësitë? Si mund t'i bëjmë ata pjesë të qeverisjes? Si mund të nxisim tolerancën, aktivizimin dhe frymën e qytetarisë? Ne besojmë se përgjigja gjendet te besimi dhe mbështetja. Të rinjtë ndoshta kanë pasiguritë e moshës. Mungesa e eksperiencës, nga ana tjetër, i bën pasivë. Por një gjë është e sigurtë. Mbështetja e tyre dhe angazhimi në të tilla procese vendimmarrëse është frytdhënës në të



gjitha nivelet dhe për të gjithë komunitetin.

Të rinjtë e Këshillit Rinor të rrethit të Kurbinit zhvilluan një marshim ndërgjegjësues për angazhimin në vendimmarrje dhe aktivizimin rinor edhe të të rinjve të tjerë të komunitetit ku ata bëjnë pjesë.

Ky marshim synoi të krijojë një impakt në mbarë komunitetin e rrethit të Kurbinit mbi rolin e Këshillit Rinor si një strukturë që tashmë aktivizohet rregullisht në vendimmarrje vendore e në shërbime vullnetare. Nga ana tjetër, ky marshim kishte si qëllim nxitjen dhe aktivizimin edhe të të rinjve të tjerë të rrethit në aktivitete sociale.

dendur në gjuhë që është e ngarkuar me fjalor profesional, gjë që mund të përbëjë një pengesë për të kuptuarit e këtyre çështjeve nga brezat më të rinj. Por, para së gjithash, gjithëpërfshirja rinore dhe angazhimi qytetar është një e drejtë qytetare e publike e cila kërkon zbatim rigoroz nga të gjitha strukturat shtetërore.


Nëpërmjet këtij projekti, i cili ishte një kombinim i njohjes me argëtimin, u synua ndërgjegjësimi i të rinjve të rrethit të Kurbinit mbi përfshirjen e tyre në vendimmarrje. Për herë të parë u ngrit struktura e Këshillit Rinor në Bashkinë e Rrethit Kurbini e përbërë nga 19 nxënës. Rritja e besimit dhe përthithja e sa më shumë të rinjve është një sfidë



Financuar nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit "YOUth FOR CHANGE"

i cili realizohet me mbështetjen financiare të LevizAlbania dhe është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

Shumëkujt mund t'i lindë pyetja si është ekuilibri mes mundësive që ofron zona e Kurbinit dhe sfidave apo vështirësive me të cilat përballen banorët e tij rrethi?

Pikat e forta të rrethit të Kurbinit:

- Ekzistenca e disa organizatave me karakter vullnetar të cilat synojnë angazhimin e komunitetit në fusha të ndryshme.
- Komunitet bashkëpunues e tolerant sidomos ndaj personave në nevojë, familjeve të prekura nga tërmeti e grupeve të ndryshme vulnerabël.
- Komunitet i aftë dhe i ndërgjegjësuar në evidentimin e problemeve sociale.
- Komunitet i cili ka kultivuar ndjenjën e fortë të lidhjes familjare e bashkë me të edhe respektin për të afërmit dhe miqtë, nderin, besën, mikpritjen dhe bujarinë e rrallë.
- Është vendi i katër manastireve benediktiane dhe i kuvendeve françeskanë dhe më shumë se 30 kishave, një pjesë e të cilave janë monume të denja të arkitekturës; është vendi i katër kështjellave mesjetare etj.

Efektet e këtyre pikave të forta:

- Orientim drejt një shoqërie tolerante, bashkëpunuese e gjithëpërfshirëse.
- Potenciale zhvillimi shoqëror përmes një vëmendjeje e orientimi të kualifikuar drejt nismave sociale e proceseve vendimmarrëse.

Pikat e dobëta të rrethit të Kurbinit:

- Mungesë e ambienteve sportive dhe kulturore për të gjitha grupmoshat dhe kategoritë.
- Nivel i lartë i papunësisë kryesisht në moshat e reja.
- Shkallë e lartë e emigrimit dhe e migrimit të banorëve.
- Nivel i lartë i ekonomisë informale.
- Mungesa e iniciativave të organizatave jofitimprurëse për të përmirësuar jetën e komunitetit.
- Angazhim shumë i ulët qytetar në çështje komunitare e procese vendimmarrëse.
- Mungesa e edukimit formal dhe e të mësuarit informal dhe aftësive për të rinjtë që do të rrisin mundësitë e tyre për punësim.
- Mungesa e qendrave për personat me aftësi të kufizuara në territorin e komunës, ku ata do të jenë në gjendje të kryejnë aktivitete të caktuara të përshtatshme për ta në këtë zonë.
- Mospërfshirja e grupeve sociale të marginalizuara.
- Mungesa e informimit dhe sensibilizimit të qytetarëve për çështjet sociale që prekin shoqërinë.
- Investimet në turizëm janë kryesisht në nivel familjar dhe nuk ofrojnë shumë mundësi për punësim.

Efektet e këtyre mangësive:

- Mungesë e theksuar e aktiviteteve sociale, sportive dhe kulturore për të gjitha grupmoshat dhe kategoritë.
- lindjen dhe zhvillimin që në moshë të hershme të disa sjelljeve dhe qëndrimeve sociale që janë shumë larg parimeve të një shoqërie të shëndetshme e demokratike.
- Rritjen e plakjes së popullsisë së zonës.
- Shtimin e të rinjve pasivë dhe pa dëshira në angazhime komunitare.

Këto probleme janë të dukshme në të gjitha njësitë administrative të zonës ku shumica e familjeve kanë nivel të ulët të të ardhurave dhe një numër i konsiderueshëm i të rinjve migrojnë në zona të tjera të vendit për punë sezonale dhe jashtë vendit për punë të përhershme.

Përfshirja e vazhdueshme e komunitetit ndihmon të kuptohet se ku duhen ofruar shërbime plotësuese, si duhen përmirësuar e shfrytëzuar burimet dhe ku duhen përqendruar aktivitetet dhe investimet në të ardhmen.

Financuar nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit
“YOUth FOR CHANGE”

i cili realizohet me mbështetjen financiare të LevizAlbania dhe është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

EDITORIAL

Rëndësia e zbatimit të projekteve sistematike të shoqërisë civile për të siguruar informacionin dhe mbështetjen e të rinjve drejt integrimit në Bashkimit Evropian

Enejda Groshi

Prej kohësh edhe vendi ynë po i nënshtrohet procesit drejt integrimit evropian i cili do të ofrojë mundësi e nxitje për zhvillim e përmirësim të shumë shërbimeve. Integrimi Evropian shqiptar është kuptuar si një proces ku secili hap do të duhet të zbatohet me rigorozitet dhe vendi do të duhet të zbatojë reforma thelbësore për të siguruar më shumë arritje.

Por, më shumë sesa kërkohet nga Bashkimi Evropian, reforma të tilla janë shumë urgjente e të nevojshme për Shqipërinë në mënyrë që të rritet besimi në ekonominë shqiptare dhe në sistemin politik. Rritja e besimit do t'i mundësonte vendit procesin drejt integrimit evropian, përfshirë të drejtat dhe detyrimet. Përvojat në vendet të cilat sapo kanë hyrë në BE, tregojnë se transformimi i sistemit ekonomik dhe politik ka përfutur jashtëzakonisht shumë nga strategjitë e bashkëpunimit dhe para-anëtarësimit në BE. Megjithatë, është "udhëtimi evropian" ai që sjell shpërblime.

Një nga kategoritë kryesore të prekura nga zhvillimet dhe politikat e integrimit në BE do të jetë rinia. Të rinjtë janë në zemër të asaj që shumë studiues i referohen si "një krizë përfaqësimi në demokraci". Në vendin tonë, gjithashtu edhe me një demokraci të brishtë post-komuniste, situata e të rinjve është problematike, veçanërisht kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në vendimmarrje, brenda partive politike ose organizatave të shoqërisë civile. Për shkak se të rinjtë po përballen me një politikë në një periudhë mosbesimi, proteste dhe abstenimi në rritje, marrëdhënia e tyre me politikën ndoshta do të vazhdojë të ndikojë në qëndrimet dhe sjelljet e tyre të ardhshme.

Prandaj, është shumë e rëndësishme të sigurohet trajnimi për ndërtimin e kapaciteteve për këtë grup të synuar. Duhet të ketë projekte sistematike të cilat duhet të synojnë mbështetjen pozitive të të rinjve duke rritur informacionin mbi Bashkimin Evropian si dhe duke gjeneruar pritje reale për përfshirjen e tyre në këtë proces.

Të rinjtë duhet të inkurajohen dhe të mbështeten në misionin e tyre në vendimmarrje dhe konkretisht:

- të veprojnë si grupe presioni pozitiv ndaj pushtetit lokal e atij qendror,
- të kërkojnë vazhdimësinë dhe transparencën e reformave të nevojshme për integrimin në Bashkimin Evropian,
- të jenë në gjendje të ndërtojnë kapacitetet e tyre përmes mekanizmave të Bashkimit Evropian në dispozicion të shoqërisë civile, përfshirë edhe rininë.

Ekziston një nevojë urgjente për të përmirësuar cilësinë e arsimit, veçanërisht pasi emigrimi nga njerëz të rinj dhe të aftë është i lartë ndërsa mundësitë e punës janë më të ulëta. Të rinjtë shqiptarë dhe shoqatat e tyre përfaqësuese të rinisë duhet të informohen paraprakisht mbi instrumentet në dispozicion që i lejojnë ata të ndjekin përfshirjen e tyre në ciklin e politikave duke mbrojtur interesin e të rinjve.



Financuar nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

*Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit
"YOUth FOR CHANGE"*

*i cili realizohet me mbështetjen financiare të LevizAlbania dhe është një
projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.
Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues
dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht
me qëndrimet e donatorit.*

REFLEKSIONE RINORE

“Rinia thesari i pazbuluar”

Nga Eriola Hysa
Gjimnazi Milot

Të gjithë thonë:- Rinia është e ardhmja e një kombi, por kjo e jona është e pazbuluar.

Artistë e politikan ngrihen në mbështetje të rinisë vetëm në ditë të caktuara, ndërsa në ditët e tjera e lënë në skutat e harresës dhe pastaj thonë se rinia nuk është aktive dhe kohën e lirë e shkojnë dëm. Shumë pak ambiente organizata ose grupe të ndryshme janë në dispozicion të rinisë dhe këto me kapacitet të limituar. Ne kërkojmë thjesht mbështetje për të bërë veprimtari, aktivitete e gjëra të tjera në të mirë të gjithkujt. Mos vallë po kërkojmë shumë? Edhe për sa kohë do të mbetemi thesar i pazbuluar? Në vend që të investojnë për rininë investojnë për protesta për t'i zënë karrigen njëri-tjetrit. Dita Ndërkombetare e Rinisë po afron dhe jam e sigurt se pavarishtë situatës ku ndodhemi të gjithë do të ngrihen në mbështetje të rinisë ndërsa në ditët në vazhdim na lënë mënjanë. Na quajnë të papërgjegjshëm, të llastuar nga teknologjia dhe të përkedhelur nga koha që jetojmë, të atillë që nëse do kishim jetuar përpara 50 viteve nuk do kishim mbijetuar dot. Sa e vertetë është kjo? Jo të gjithë njerezit janë njësoj, kështu që ka edhe nga ata të rinj që s'duan të angazhohen, por jam e sigurt se pasi të shihnin të mirat dhe eksperiencat që do të fitonin në te qenit aktiv jam e sigurt se do të na bashkoheshin. Rinia është plot ide dhe ne jemi të fortë gjithashtu. Ne mund t'ia dalim mbanë me sfidat e jetës. Edhe sikur të kishim jetuar përpara 50 viteve do t'ia kishim dalë mbanë sikur të kishim mbështetjen që sot po e kërkojmë, bota do të ishte një vend më i mirë.

“YOUTH FOR CHANGE!” “RINIA PER NDRYSHIM!”

Ky është mesazhi që dua të përcjell sot të gjithëve.

Mbeshtesni rininë sot që nesër të kemi një të ardhme më të mirë!

Të ardhmen tonë e krijojmë vetë apo ajo është e destinuar?

Nga Armela Dema
Gjimnazi “Arif Halil Sulaj” Mamurras

Pas karantinës besoj që secilit prej nesh i bluan koka mendime të ndryshme të lidhura me atë çka do na prsë në vazhdim. Nuk besoj që ndonjëri prej jush ka mbetur pa thënë –“Po tani çfarë?”

Distancimi social, venja e maskave dhe dorezave, mbajtja e një desifektanti, janë rregullat që janë vënë për në vazhdim. Por përse u vendosen këto rregulla? Kjo është një pyetje që e ka një përgjigje, por përgjigjia nuk dihet se nga erdhi.

Koronavirusi, virusi që kaploi të gjithë botën për një kohë të shkurtër, kjo është përgjigjia. Ai i mori jetën shumë personave, vendosi krizën në çdo vend duke lënë miliona persona në të gjithë botën pa punë. Shkurt, ai paralizoi çdo gjë. Por si erdhi kjo kaq papritmas për njerzimin? Si ky virus mori nën kontroll çdo gjë që ka të bëjë me ne? Ja pra këto janë disa pyetje që me sa duket do mbeten kështu, me pikpyetje .

Ajo çka ne si njerëz mund të bëjmë është që të kujdesemi për veten dhe për të afermit tanë. Dhe me sa duket, pas kësaj ngjarjeje po kuptohet që e ardhmja nuk është më në dorën tonë. Por ju mos jini pesimistë, por shijoni momentin sepse nuk i dihet se çfarë na është rezervuar për në vazhdim.

Financuar nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit

“YOUTH FOR CHANGE”

i cili realizohet me mbështetjen financiare të LevizAlbania dhe është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

REFLEKSIONE RINORE

Ti je ndryshimi, mos u dorëzo kurrë!

Alfond Zymaj
Gjimnazi At'Shtjefen Gjecovi

Kurrë mos u dorëzo ! Ti nuk mundesh të dorëzohesh pikërisht tani. Bekimet e dikujt janë bekimet e dikujt dhe bekimet e tua janë bekimet e tua. Merr atë që është e jotja. Bejë për veten tënde.
Cdo ditë duhet të zgjohesh me një përgjegjësi mbi shpatulla. Dhe kjo nuk do të thotë të bësh për të qenë mirë për të tjerët pa qenë mirë për vete! Kjo do të thotë të mos dorëzohesh për veten tënde, për familjen tënde dhe për të dashurit e tu, për të treguar se je i pathyeshëm!
Por të mos dorëzohesh nuk lidhet vetëm me përgjegjësitë e tua por edhe me njerzit që të rrethojnë, ti duhet të jesh ndryshimi, duhet të sjellësh lajme të mira, mundësi, dije, dritë. Nga njerzit e vegjël nisin ndryshimet e medha.
Nëse po më kupton se çfarë po them vazhdo, jepi, tregoje kush je.
He , hey shiko...
Mos harro kurrë se të qenurit mirë për vete është të qenurit mirë edhe për të tjerët, por që rrallë herë ndodh pasi ne ecim me iden se të qenurit mirë për të tjerët është mirë edhe për ne!
Gëzimi yt, e ardhmja jote, është e bazuar në atë çfarë ti e ndërton vetë me forcat e tua, jo me mendimet dhe punët e të tjerëve. Por nuk mund të jesh i lumtur dhe i gëzuar cdo ditë por pavarësisht çfarë ndodh mos u dorëzo por shijoi momentet e vështira duke u argëtuar, duke u forcuar, duke u ngritur akoma më lart se aty ku je.
Jeta jote është e dhënë nga Zoti por mënyra sesi ti i shfrytëzon bekimet e tij është e varur nga ti. Cdo njeri e ka një mision në këtë jetë, pra ti je ndryshimi. Kështuqë mos u dorëzo, por lufto, përpiku, jep me të mirën. Ti je ndryshimi, TI JE E ARDHMJA. Mos u dorëzo deri në frymën e fundit. TI MUNDESH !

Të ardhmen e kemi në dorë vetë, apo të tjerët?

Nga Anita Leka
Gjimnazi "Arif Halil Sulaj" Mamurras

Personalisht kur mendoj për të ardhmen marr frymë thellë dhe nuk arrij në asnjë konkluzion, çdo gjë e së ardhmes më shfaqet e paqartë. Frika, ankthi dhe dëshira për të arritur diçka më bën një lëmsh në grykë, i cili më pengon në frymarrje. E gjithë e ardhmja mbase është në dorën tonë. Mund t'a krahasojmë me shkrimin në një fletë të bardhë, me anë të një pene. Me të cilën duhet të punojmë me kujdes që në fillim, pasi një pakujdesi e vogël mund të njoshtë bardhësinë e fletës. Nëse ti e njollos, e ndot bardhësinë e saj, por nëse ti kupton gabimin dhe vazhdon të shkruash me bukur duke i kushtuar vëmendje përmbajtjes së saj, njolla do të menjanohet... Lexuesi i kësaj letre do marrë kënaqësi nga përmbajtja e saj aq sa njolla do figurohet tek ai thjesht si një detaj dhe jo gabim. Prandaj e kemi në dorë në një mënyrë se sa përpikemi, lodhemi dhe djersisim për të ardhmen tonë.


Fatkeqësisht jo gjithmonë është e varur nga ne. Unë sot bashkë me moshatarët e mi jemi tërësisht të varur nga prindërit. Kjo ndoshta padrejtësi e jetës pasi ne nuk mund të zgjedhim mënyrën e jetesës apo vetë prindërit. Kjo të pengon sadopak... Por... pavarësisht vogëlsirave që ndikojnë në të ardhmen tonë, jam e mendimit që e ardhmja është vetëm në dorën tonë. Ajo është pasqyrimi i përpjekjes sonë.

Kështu që ne të gjithë të qetësohemi dhe të mendohejmë që të japim më të mirën tonë në mënyrën që e ardhmja të na ofrojë më të mirën e saj. Kurrë nuk është vonë që ne të ndryshojmë për të përmirësuar jetën tonë ...

Financuar nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit "YOUth FOR CHANGE"

i cili realizohet me mbështetjen financiare të LevizAlbania dhe është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.